



LIBËR BURIMOR
MBI FINANCIMIN E QËNDRUESHËM PËR BIODIVERSITETIN,
EKOSISTEMET & ZONAT E MBROJTURA
NË BALLKANIN PERËNDIMOR

FJALORTHI:
SHPREHJET & PËRKUFIZIMET KYÇE

Mladen Lazić dhe Lucy Emerton

Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Agjenda 2030	Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, përfshirë 17 objektivat e saj të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) dhe 169 synimet, u miratua më 25 shtator 2015 nga Krerët e Shteteve dhe Qeverive në një samit të veçantë të KB-së. Angazhohet të zhdukë varfërinë dhe të arrijë zhvillim të qëndrueshëm deri në vitin 2030 në mbarë botën.
Përshtatja (shih Përshtatja e klimës)	Në kontekstin specifik të ndryshimit të klimës, masa për tu përshtatur me ndryshimet aktuale ose të pritshme të klimës, që kërkon ë zvogëlim e ndjeshmërisë së sistemeve njerëzore ose natyrore ndaj efekteve të dëmshme të ndryshimit të klimës (p.sh. ngritja e nivelit të detit, ngjarjet më ekstreme të motit ose pasiguria ushqimore). Kjo gjithashtu përfshin shfrytëzimin sa më të madh të mundësive potenciale të dobishme që lidhen me ndryshimin e klimës (për shembull, sezonet më të gjata të rritjes, rendimentet e rritura ose zvogëlimi i mungesës sezonale të ujit).
Masat agro-mjedisore	Siç përcaktohet nga BE, masat agro-mjedisore janë krijuar për të inkurajuar fermerët të mbrojnë dhe përmirësojnë mjedisin në tokën e tyre bujqësore duke i paguar ata për ofrimin e shërbimeve mjedisore. Fermerët angazhohen që, për një periudhë minimale prej të paktën pesë vjetësh, të adoptojnë teknika të bujqësisë që janë miqësore me mjedisin, përtej detyrimeve ligjore. Si rezultat, ata marrin pagesa që kompensojnë çdo kosto shtesë dhe të ardhura të prapambetura.
Objektivat Aichi të Biodiversitetit	Objektivat Aichi të Biodiversitetit përfshihen në Planin Strategjik për Biodiversitetin 2011-2020, të miratuar nga Konferenca e Palëve në Konventën për Diversitetin Biologjik në vitin 2010. Ato përmbajnë 20 objektiva të kufizuara në kohë, për matjen e biodiversitetit, që duhen përmbytur deri në vitin 2020.
Investitori “Engjëll”	Një individ që përdor fondet e veta për të siguruar mbështetje financiare (dhe nganjëherë lloje të tjera) për fillestarë ose sipërmarrës të vegjël, shpesh në këmbim të pronësisë së kapitalit në kompani.
Klasa e asetëve	Një grupim i investimeve që shfaqin karakteristika të ngjashme dhe i nënshtrohen të njëjtave ligje dhe rregullore. Zakonisht thuhet se ekzistojnë katër klasa të asetëve: aksione ose kapitale, obligacione ose instrumente me të ardhura fikse, tregu i parasë ose ekuivalentët e parave të gatshme, dhe pasuritë e paluajtshme ose asetet e tjera të prekshme (të tilla si mallra, kontrata, derivate të tjera financiare, e madje edhe Kripto-Valutat).
Biodiversiteti	Llojllojshmëria midis organizmave të gjallë nga të gjitha burimet, përfshirë, ekosistemet tokësore, detare dhe të tjera ujore dhe komplekset ekologjike, pjesë të së cilës ato janë. Kjo përfshin diversitetin brenda specieve, midis specieve dhe ekosistemeve.
Bankimi i biodiversitetit	Shih bankimin e habitatit.
Bizneset e biodiversitetit	Ndërmarrjet tregtare që gjenerojnë fitime përmes aktiviteteve që ruajnë dhe ndikojnë pozitivisht në biodiversitet, përdorin burime biologjike në mënyrë të qëndrueshme dhe ndajnë përfitimet që rrjedhin nga ky përdorim në mënyrë të barabartë.
Kompensimet e biodiversitetit	Veprimet e ruajtjes së biodiversitetit që kanë për qëllim të kompensojnë ndikimin e mbetur, e të pashmangshëm në biodiversitetin e shkaktuar nga projektet. Ato zakonisht përfshijnë investime në rehabilitimin ose ruajtjen e burimeve ekuivalente, habitateve apo edhe specieve në një zonë tjetër. Qëllimi është të sigurohet që të mos ketë paktën humbje neto të biodiversitetit dhe, kur është e mundur, të ketë një fitim neto. Kompensimet zakonisht ndiqen si zgjidhje e fundit, vetëm në fund të hierarkisë lehtësuese, pasi që dëmi në mjedisin relevant është zvogëluar dhe zbutur sa më shumë që të jetë e mundur.
Produktet e bazuara në biodiversitet	Produkte nga të cilat varen ose rrjedhin burimet biologjike (përfshirë speciet, gjenet dhe ekosistemet) si një input kryesor ose lëndë e parë.
Produktet miqësore ndaj biodiversitetit	Produkte që janë marrë, prodhuar dhe / ose përpunuar në atë mënyrë që të mos dëmtojnë biodiversitetin ose, mundësisht, të promovojnë ruajtjen, përdorimin e qëndrueshëm dhe ndarjen e barabartë të përfitimeve midis palëve të interesuara.
Tregtia bio	Mbledhja, prodhimi, transformimi dhe tregtimi i mallrave dhe shërbimeve që rrjedhin nga biodiversiteti në bazë të kriterëve të qëndrueshmërisë mjedisore, shoqërore dhe ekonomike.
Financimi i përzier	Përdorimi i financave për zhvillim nga qeveritë, bankat e zhvillimit apo agjencitë e tjera në terma koncesionarë (për shembull nën nivelin e tregut ose në kombinim me asistencën teknike) për të përshpejtuar dhe mobilizuar financat tregtare.
Marka	Një identitet, histori, dhe zakonisht - emblemë e veçantë e cila shoqërohet me një produkt, zonë, dhe / ose rajon të veçantë.
Tregjet e kapitalit	Një treg në të cilin blerësit dhe shitësit tregtojnë letra me vlerë financiare dhe instrumente të tjera (të tilla si letra me vlerë, aksione, obligacione, borxhe dhe investime të tjera afatgjata). Ato ofrojnë një mekanizëm për kanalizimin e pasurisë së kursimtarëve dhe investitorëve në drejtim të atyre që kërkojnë kapital, siç janë ndërmarrjet ose qeveritë. Shembuj përfshijnë tregun e aksioneve, tregun e letrave me vlerë, valutat dhe tregjet e huaja të këmbimit.
Marketingu i lidhur me shkahun	Një bashkëpunim reciprokisht i dobishëm midis një kompanie fitimprurëse dhe organizatave bamirëse, fondacioneve ose organizatave të tjera jo-fitimprurëse / të interesit publik, të krijuara për të promovuar shitjet e të parëve dhe kauzën e të dytëve. Shpesh përfshin ndarjen e një pjese të të ardhurave të gjeneruara nga shitja tregtare e mallrave dhe shërbimeve, ose futja e një tarife shtesë, donacionit ose mbitaksës për një çmim produkti.

Certifikimi	Procesi i matjes, testimit dhe verifikimit që një mall ose shërbim ka përmbushur kërkesat e specifikuar në prodhimin, shitjen ose dorëzimin e tij. Zakonisht kryhet në baza periodike dhe të ripërtërisht nga një agjenci e pavarur e palëve të treta dhe jepet sipas kriterëve të rrepta dhe të përcaktuara mirë.
Kapitulli 27 për Mjedisin	Seksioni i acquis i BE-së që merret me mjedisin, që përfshin mbi 200 akte kryesore ligjore që mbulojnë legjislacionin horizontal, cilësinë e ujit dhe ajrit, menaxhimin e mbeturinave, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e rrezikut, kemikalet dhe organizmat e modifikuar gjenetiki (OMGJ), zhurmën dhe pylltarinë. Pajtueshmëria me acquis kërkon investime të konsiderueshme.
Përshtatja ndaj klimës	Masat për tu përshtatur me ndryshimet e aktuale ose të pritshme të klimës, që kërkojnë zvogëlim të ndjeshmërisë së sistemeve njerëzore ose natyrore ndaj efekteve të dëmshme të ndryshimit të klimës (p.sh. ngritja e nivelit të detit, ngjarjet më ekstreme të motit ose pasiguria e ushqimit). Ato gjithashtu përfshijnë shfrytëzimin më të madh të mundësive potenciale të dobishme të lidhura me ndryshimin e klimës (për shembull, sezonet më të gjata të rritjes, rendimentet e rritura ose zvogëlimi i mungesës sezonale të ujit).
Zbutja e klimës	Masat për zvogëlimin, stabilizimin ose parandalimin e emetimit të gazrave serë në atmosferë, për shembull duke zvogëluar burimet e këtyre gazrave (p.sh. Djegia e karburanteve fosile për energji elektrike, ngrohje ose transport), përmirësimin e “deponive” që grumbullojnë dhe ruajnë këto gazra (p.sh. oqeanet, pyjet, kënetat, kullotat dhe tokat), ose duke adoptuar teknologji të reja dhe të përmirësuara (p.sh. energjia e ripërtrishme, përmirësimi i pajisjeve të vjetra ose joefikase, përmirësimi i projektimit dhe planifikimit).
Koncesioni	Një e drejtë kontraktuale për të zhvilluar një biznes ose aktivitet tjetër në një zonë të caktuar, të tilla si ato që eksplorojnë ose zhvillojnë burimet e saj natyrore ose ofrojnë shërbime tregtare (restorante, dyqane dhuratash, ture me guidë, hotele). Procesi i përzgjedhjes për koncesion zakonisht bëhet përmes një procesi të tenderimit ofertues.
Bankimi i ruajtjes së mjedisit	Shih bankimin e Habitatit.
Lehtësimi i ruajtjes së mjedisit	Një marrëveshje vullnetare, ligjore që kufizon në mënyrë të përhershme përdorimin e tokës në mënyrë që të mbrojë vlerat e saj të ruajtjes.
Fondi i mirëbesimit për ruajtje të mjedisit	Institucionet private, juridikisht të pavarura të krijuara për të përshpejtuar burimet dhe të cilat ofrojnë burime stabile, të qëndrueshme, afatgjata të financimit për mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në fushat e biodiversitetit të lartë. Ato shërbejnë si mekanizma për të mobilizuar fonde nga një sërë donatorësh të ndryshëm, qeveritë dhe sektori privat, me qëllim të arritjes së qëllimeve të ruajtjes së mjedisit.
Konventa mbi Diversitetin Biologjik	Konventa për Diversitetin Biologjik është një traktat ndërkombëtar ligjorisht detyrues me tri objektiva kryesore: ruajtjen e biodiversitetit, përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit, dhe ndarjen e drejtë dhe të barabartë të përfitimeve që vijnë nga përdorimi i burimeve gjenetike. Ajo u hap për nënshkrim në Samitin e Tokës në Rio de Janeiro në vitin 1992, dhe hyri në fuqi në vitin 1993.
Përgjegjësia mjedisore dhe shoqërore e korporatave	Përgjegjësia shoqërore e korporatës është një koncept përmes të cilit ndërmarrjet integrojnë shqetësimet shoqërore dhe mjedisore në veprimet e tyre të biznesit dhe në bashkëveprimin e tyre me palët e interesuara në baza vullnetare.
Financimi në masë	Një mënyrë për të grumbulluar fonde përmes një përpjekje kolektive, zakonisht duke kërkuar donacione për një çështje të veçantë, e cila bëhet online. Kjo në mënyrë tipike funksionon në bazë të një numri të madh njerëzish, ku secili kontribuon një sasi të vogël parash. Zakonisht janë konsideruar të jenë katër kategori të financimit në masë: dhurimet e bazuara në donacione ose bamirësi, të bazuara në shpërblim, të bazuara në borxhe dhe kapital (shiko përkufizimet më poshtë).
Obligacionet	Një letër me vlerë afatgjatë që jep një normë fikse të interesit, e lëshuar nga një kompani dhe e siguruar kundrejt aktiveve.
Financimi i borxhit	Paratë që duhet të paguhet, zakonisht me kamatë, me kushte që përcaktojnë madhësinë e kredisë, normën e interesit, dhe maturimin ose datën e rinovimit. Mund të merr formën e kredive nga një bankë ose ndonjë ndërmjetës tjetër financiar, ose letrat me vlerë siç janë obligacionet qeveritare dhe të korporatave, certifikatat e depozitave dhe letrat me vlerë të kolateralizuara.
Shkëmbime të borxhit për natyrën	Shkëmbimet e borxhit për natyrën janë transaksione financiare në të cilat një pjesë e borxhit të huaj i një vendi në zhvillim i falet atij në këmbim të investimeve vendore në masat e ruajtjes së mjedisit.
Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë	Koncepti dhe praktika e zvogëlimit të rreziqeve nga fatkeqësitë përmes përpjekjeve sistematike për të analizuar dhe menaxhuar faktorët shkakorë të fatkeqësive, duke përfshirë edhe zvogëlimin e ekspozimit ndaj rreziqeve, zvogëlimin e cenusshmërisë së njerëzve dhe pronave, menaxhimin e mençur të tokës dhe mjedisit dhe përmirësimin e gatishmërisë për ngjarjet e pafavorshme.

Eko-certifikimi	Procesi i matjes, testimit dhe verifikimit se një mall ose shërbim ka përmbushur kriteret e caktuara të performancës mjedisore dhe ndikimit në prodhimin, shitjen ose dorëzimin e tij. Zakonisht kryhet në baza periodike dhe të ripërtërishe nga një agjenci e pavarur e palëve të treta, dhe jepet sipas kriterëve të rrepta dhe të përcaktuara mirë. Shumica e shërbimeve të certifikimit shoqërohen me një logo (një eko-etiketë).
Eko-etiketimi	Një eko-etiketë identifikon preferencën e përgjithshme mjedisore të një produkti (p.sh. mall ose shërbimi) brenda një kategorie produkti bazuar në konsideratat e ciklit jetësor dhe jepet nga një palë e tretë e paanshme për produktet që plotësojnë kriteret e përcaktuara të udhëheqjes mjedisore.
Transferet ekologjike-fiskale	Përfshirja e kriterëve mjedisore (siç janë zonat e mbrojtura, zonat e menaxhimit të pellgjeve apo pasuria e biodiversitetit) në kriteret ose formulën e përdorur për të përcaktuar rishpërndarjen e të ardhurave fiskale nga niveli kombëtar në atë nën-kombëtar. Ato shërbejnë si një mënyrë për të shpërblyer dhe kompensuar kostot lokale të ruajtjes së mjedisit.
Ekosistemi	Një kompleks dinamik i bashkësive bimore, shtazore dhe mikroorganizmave dhe ambienti i tyre jo i gjallë që bashkëvepron si një njësi funksionale. Kjo mund t'i referohet çdo njësie funksionuese në çfarëdo shkalle (p.sh. një grimcë dheu, një pellg, pyll, biomë ose e tërë biosfera). Njerëzit janë një pjesë integrale e ekosistemeve.
Përshtatja e bazuar në ekosistem	Përdorimi i biodiversitetit dhe shërbimeve të ekosistemit, si pjesë e një strategjie të përgjithshme të adaptimit për të ndihmuar njerëzit të përshtaten me efektet e pafavorshme të ndryshimeve të klimës (p.sh. bujqësia e qëndrueshme, menaxhimi i integruar i burimeve ujore, restaurimi i ligatinave bregdetare, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve). Shih Përshtatjet, përshtatjet e klimës.
Shërbimet e ekosistemit	Përfitimet që njerëzit i sigurojnë nga ekosistemi. Ato përfshijnë shërbimet furnizuese siç janë ushqimi dhe uji; shërbimet rregulluese si: përmytja dhe kontrolli i sëmundjeve; shërbimet kulturore si përfitime rekreative dhe kulturore; dhe shërbime mbështetëse të tilla si ciklet ushqyese që ruajnë kushtet për jetën në Tokë.
Ekoturizmi	Udhëtimi i përgjegjshëm në zona natyrore që ruan mjedisin, mbështet mirëqenien e popullatës lokale dhe përfshin interpretimin dhe edukimin.
Speciet e rrezikuara	Speciet e kafshëve të egra ose bimëve që përballen me një rrezik shumë të lartë të zhdukjes në jetën e egër në të gjithë ose në një pjesë të konsiderueshme të gamës së saj.
Fondet dhuratë	Fondet që investojnë një shumë të kapitalit dhe shpenzojnë vetëm interesin e fituar.
Acquis e BE-së	Tërësia aktuale e të drejtave, detyrimeve dhe rregullave të përbashkëta që janë të detyrueshëm për të gjitha vendet e BE-së, si anëtare të BE-së. Ajo është e ndarë në 35 fusha të ndryshme të politikave ose kapituj për qëllimin e negociatave midis BE-së dhe vendeve anëtare candidate, për secilën prej të cilave negociohet veçmas.
Direktivat e BE-së për natyrën	Tërësia e ligjeve të nivelit të BE-së që mbrojnë natyrën dhe biodiversitetin. Këto përfshijnë, Direktivën e Shpezëve (1979)-si më të rëndësishme, dhe Direktivën e Habitaveve (1992)).
Marrëveshja e Gjelbër Evropiane	Strategjia për rritjen dhe grup i nismave të politikës, të nisur në vitin 2019, e cila përcakton një plan udhërrëfyes për ta bërë ekonominë e BE-së të qëndrueshme. Qëllimet e saj neutralitetin ndaj klimës deri në vitin 2050; mbrojtja e jetës njerëzore, kafshëve dhe bimëve duke ndalur ndotjen; duke ndihmuar kompanitë të bëhen liderë botërore në produktet dhe teknologjitë e pastra; dhe sigurimi i një tranzicioni të drejtë dhe gjithëpërfshirës.
Kriteret mjedisore, shoqërore dhe qeverisëse (ESG)	Grup standardesh për operimet e një kompanie i përdorur nga investitorët dhe në tregjet e kapitalit për të vlerësuar sjelljen e korporatave dhe kontrollin e investimeve të mundshme për ndikimet e tyre mjedisore, shoqërore dhe qeverisëse. Kriteret mjedisore shqyrtojnë se si një kompani performon si një kujdestar i natyrës. Kriteret shoqërore shqyrtojnë se si ajo i menaxhon marrëdhëniet me punonjësit, furnitorët, klientët dhe komunitetet ku vepron. Qeverisja merret me udhëheqjen e saj, pagat ekzekutive, auditimet, kontrollat e brendshme dhe të drejtat e aksionarëve.
Financimi me ekuitet	Financimi nga investitorët ose aksionarët në këmbim të pjesës së pronësisë në kompani (blerja e aksioneve dhe pjesëmarrjes). Investitorët nuk paguhen, por kërkojnë të mbështesin kompaninë dhe eventualisht të shesin aksionet e tyre, në mënyrë ideale me një prim.
Kthimi financiar	Fitimi i realizuar nga investimi gjatë një periudhe kohe. Zakonisht shprehet si përqindje e proporcionit të investimit origjinal.
Bilanci fiskal	Dallimi midis të ardhurave dhe shpenzimeve të një qeverie. Kur bilanci është negativ, qeveria ka një deficit fiskal. Kur bilanci është pozitiv, qeveria ka një tepëri (suficit) fiskale.
Decentralizimi fiskal	Transferimi i përgjegjësisë të shpenzimeve dhe detyrave të ardhurave tek nivelet më të ulëta të qeverisë.
Paracaktimi fiskal (i njohur edhe si hipotekim)	Ndarja e një pjese ose e plotë e një burimi të hyrash publike nga një taksë specifike për një qëllim të veçantë të shpenzimit (siç është ruajtja e mjedisit).

Instrumenti fiskal	Instrumentet fiskale janë buxheti, tatimimi, shpenzimet publike, punimet publike dhe borxhi publik. Ato përdoren për të ndikuar në ekonomi, duke përdorur shpenzimet dhe tatimin për të inkurajuar ose kufizuar shpenzimet private për konsum dhe investime.
Grantet	Fondet ose produktet pakthyesme që janë disbursuar ose dhënë nga njëra palë (krijuesit e granteve) një marrësi. Krijuesit e granteve shpesh janë departamente qeveritare, korporata, fondacione, truste ose donatorët e zhvillimit, ndërsa marrësit shpesh janë organizata joqeveritare ose të shoqërisë civile, institucione arsimore, biznese ose individë.
Obligacioni i gjelbër	Një instrument i të ardhurave fikse, i tregtueshëm në treg të kapitalit, i synuar posaçërisht në mbledhjen e fondeve për projektet mjedisore. Obligacionet zakonisht lëshohen nga qeveritë sovraane, shtetet, bashkitë ose entitetet e korporatave për të mbledhur fonde paraprake, të mbështetura nga premtimi për t'i paguar investitorit vlerën e obligacionit plus pagesat periodike të interesit.
Buxhetimi i gjelbër	Përdorimi i mjeteve të hartimit të politikave buxhetore për të ndihmuar në arritjen e objektivave mjedisore. Kjo përfshin vlerësimin e ndikimeve mjedisore të politikave buxhetore dhe fiskale dhe vlerësimin e koherencës së tyre drejt përmirësimit të angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Buxhetimi i gjelbër gjithashtu mund të kontribuojë në debat të informuar, të bazuar në prova dhe diskutime mbi rritjen e qëndrueshme.
Projekti i gjelbër	Një projekt me qëllim për të përmirësuar një sfidë specifike mjedisore.
Habitati	Vendbanimi ose mjedisi në të cilin jeton një kafshë.
Bankimi i habitatit	Sistem i tregtisë ose shkëmbimit, në të cilin kreditë mund të përfitohen nga krijimi, rivendosja, përmirësimi ose konservimi i habitateve natyrore të specifikuara, si dhe blerja për të kompensuar ose zbutur ndikimet negative të aktiviteteve të zhvillimit në biodiversitetin dhe ekosistemet.
Degradimi i habitatit	Rënie në cilësinë e habitatit për një specie, p.sh. në lidhje me ndryshimet në disponueshmërinë e ushqimit, mbulimin ose klimën.
Copëzimi i habitatit	Procesi dhe rezultati i prishjes së zonave të habitateve të lidhura në copëza të dallueshme.
Humbja e habitatit	Zona që është bërë tërësisht e papërshtatshme për një specie.
Hipotekimi (i njohur edhe si paracaktimi fiskal)	Ndarja e një pjese ose e plotë e një burimi të hyrash publike nga një taksë specifike për një qëllim të veçantë të shpenzimit (siç është ruajtja e mjedisit).
Investimet në impakt	Investimet e bëra në kompani, organizata dhe fonde me qëllim të qartë për të gjeneruar një impakt të matshëm, të dobishëm shoqëror ose mjedisor, bashkë me një kthim financiar. Pjesa më e madhe e investimit në impakt bëhet nga investitorët institucionalë, por një gamë e kompanive të shërbimeve financiare me vetëdije shoqërore ose etike, platformat e investimeve të bazuara në internet dhe rrjetet e investitorëve tani u ofrojnë individëve një mundësi për pjesëmarrje.
Investitorët institucionalë	Institucione të mëdha, siç janë bankat, kompanitë e sigurimeve, fondet e pensioneve, fondet e sindikatës, fondet hexhi, fondet e ndërsjella, fondet e tregtuara nga këmbimi dhe donacionet që blejnë dhe shesin letra me vlerë për portofolet e tyre të investimeve. Investitorët institucionalë mund të investojnë në emër të tjerëve, ashtu edhe në kapacitetin vetanë.
Normat e interesit	Përqindja e një kredie ose depozite që ripaguhet si interes nga huamarrësi, e shprehur normalisht si përqindje vjetore.
Vlerësimi rreth ekosistemeve të mijëvjeçarit	Bazuar në thirrje të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në vitin 2000, vlerësimi i mijëvjeçarit u iniciua me qëllim të vlerësimit të pasojave të ndryshimit të ekosistemeve për mirëqenien njerëzore dhe bazës shkencore për veprime të nevojshme për të rritur ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të atyre sistemeve dhe kontributin e tyre për mirëqenien njerëzore. Për këtë qëllim ishin përfshirë më shumë se 1.360 ekspertë në mbarë botën.
Bankimi i masave zbutëse	Shih Bankimi i habitatit.
Masat zbutëse	Masat që synojnë eliminimin, zvogëlimin ose kontrollin e efekteve negative mjedisore të një projekti. Ato përfshijnë zhdëmtimin për çdo dëmtim të mjedisit të shkaktuar nga ato efekte përmes zëvendësimit, restaurimit, kompensimit ose ndonjë mjeti tjetër.
Masat zbutëse (shih masat zbutëse të Klimës)	Në kontekstin specifik të ndryshimit të klimës, masat për të zvogëluar, stabilizuar ose parandaluar emetimin e gazrave serë në atmosferë, për shembull duke zvogëluar burimet e këtyre gazeve (p.sh. djegia e karburanteve fosile për energji elektrike, ngrohje ose transport), duke rritur "deponitë" që grumbullojnë dhe ruajnë këto gaze (p.sh. oqeanet, pyjet, ligatina, kullotat dhe tokat), ose duke adoptuar teknologji të reja dhe të përmirësuara (p.sh. energjia e ripërtrishme, përmirësimi i pajisjeve të vjetra ose joefikase, përmirësimi i projektimit dhe planifikimit).

Hierarkia e masave zbutëse	Në kontekstin specifik të mjedisit, biodiversitetit dhe ruajtjes së ekosistemit, hierarkia e masave zbutëse përcaktohet si: shmangia (masat e marra në fillim për të shmangur krijimin e impakteve), minimizimi (masat e marra për të zvogëluar kohëzgjatjen, intensitetin dhe / ose shtrirjen e impakteve që nuk mund të shmangen plotësisht), kompensimi (masat e marra për të kompensuar ndonjë impakt domethënës të mbetur, të dëmshëm që nuk mund të shmanget, minimizohet dhe / ose rehabilitohet ose restaurohet, për të mos pasur humbje neto ose mundësisht për të pasur një fitim neto të biodiversitetit), dhe zhdëmtimi (masa për zhdëmtim, për të rregulluar ose për të paguar dëmet për humbjen e biodiversitetit të shkaktuar nga një projekt që dështon në synimin të mos ketë humbje neto ose fitim neto).
Fondet e ndërsjella	Program investues i menaxhuar profesionalisht, i cili bashkon fondet e investorëve dhe i investon ato në një portofol të larmishëm të kapitalit, bonove dhe letrave me vlerë të tjera. Secili aksionar merr pjesë proporcionale në fitimet ose humbjet e fondit.
Natura 2000	Një rrjet zonash për shumim dhe qëndrim domethënës të specieve të rralla dhe të kërcënuara, dhe disa llojeve të rralla të habitatit natyror të cilat mbrohen në vete. Shtrihet në të 28 vendet e BE-së, si në tokë ashtu edhe në det. Qëllimi i rrjetit është të sigurojë mbijetesën afatgjatë të specieve dhe habitateve më të vlefshme dhe të kërcënuara të Evropës, të listuara si në Direktivën e Shpendëve ashtu edhe në Direktivën e Habitareve.
Parimi 'pa humbje neto'	Shmangia e humbjes neto të biodiversitetit dhe shërbimeve të ekosistemit, dëmeve që vijnë nga aktivitetet njerëzore duke balancuar së paku me fitimet ekuivalente.
Investimet në vend të huaj (offshore)	Mbajtja e fondeve në juridiksion tjetër jashtë shtetit të dikujt. Shprehja mund të përdoret për të përshkruar bankat e huaja, korporatat, investimet dhe depozitat. Juridiksionet në vende të huaja janë një mënyrë e pranuar zakonisht për të zvogëluar taksat e vendosura në shumicën e vendeve si për investitorët e mëdhenj dhe investitorët e vegjël.
Kosto e oportunitetit	Heqja dorë nga një përfitim, profit ose vlerë e një gjëje për të përvetësuar ose arritur diçka tjetër. Meqenëse çdo burim mund të vihet në përdorim alternativ, çdo veprim, zgjedhje ose vendim ka një kosto oportuniteti të shoqëruar.
Marrëveshja e Parisit për Ndryshimin e Klimës	Marrëveshja e arritur në vitin 2015 nga Palët në Konventën kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin e Klimës. Ajo përcakton një kornizë globale për të shmangur ndryshimin e rrezikshëm të klimës duke kufizuar ngrohjen globale nën 2°C dhe duke ndjekur përpjekjet për ta kufizuar atë në 1.5°C. Ajo gjithashtu synon të forcojë aftësinë e vendeve për t'u marrë me ndikimet e ndryshimit të klimës dhe t'i mbështesë ato në përpjekjet e tyre.
Pagesat për shërbimet e ekosistemit (PSHE)	Transferet e parave të gatshme ose burimeve të tjera ndërmjet përfituesve të shërbimit të ekosistemit dhe ofruesve. Ato janë një mënyrë për të funksionalizuar qasjen 'përdoruesi paguan' në lidhje me shërbimet e ekosistemit. Përveç krijimit të fondeve, ato shërbejnë si stimuj për të inkurajuar menaxherët e tokës dhe burimeve të ruajnë biodiversitetin dhe ekosistemet gjatë veprimtarisë së tyre ekonomike.
Buxheti i bazuar në performancë	Një buxhet i avancuar programor, i përdorur zakonisht nga organet qeveritare dhe agjencitë për të treguar lidhjen midis fondeve të tatimpaguesit dhe rezultatit të shërbimeve të ofruara nga qeveritë federale, shtetërore ose lokale.
Subvencionet "perverse"	Subvencione që synojnë të mbështesin ose stimulojnë një sektor ose aktivitet të veçantë që ka efekte negative sociale, ekonomike dhe / ose mjedisore për një periudhë afatgjatë. Shembuj përfshijnë subvencione për të inkurajuar prodhimin (shfrytëzimin e paqëndrueshëm) të bujqësisë, karburanteve fosile, ujin dhe peshkimin.
Parimi ndotësi paguan	Ndotësi duhet të bartë koston e masave për të zvogëluar ndotjen në bazë të masës së dëmtimit shkaktuar shoqërisë ose tejkalimit të një niveli të pranueshëm (standardi) të ndotjes. Parimi 'ndotësi paguan' është pjesë e Deklaratës së Rio-s për Mjedisin dhe Zhvillimin të vitit 1992, e dakorduar në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin (UNCED, e njohur zakonisht si Samiti i Tokës).
Investitor privat	Individët dhe kompanitë që investojnë paratë e tyre në një kompani.
Buxheti programor	Një buxhet i hartuar për një aktivitet apo program specifik.
Zona e mbrojtur	Hapësirë gjeografike e mirë përcaktuar, e njohur, e dedikuar dhe e menaxhuar përmes mënyrave ligjore ose mënyrave të tjera efektive, që sigurojnë mbrojtjen afatgjatë të natyrës dhe shërbimeve të ekosistemeve që lidhen me të, dhe vlerave kulturore.
Menaxhimi i financave publike	Grupi i ligjeve, rregullave, sistemeve dhe proceseve të përdorura nga shtetet (dhe qeveritë në nivelin kombëtar) për të mobilizuar të ardhurat, alokimin e fondeve publike, ekzekutimin e shpenzimeve publike, llogaridhënien dhe rezultatet e auditimit. Objektivat e gjera të menaxhimit të financave publike janë që të arrihet disiplina e përgjithshme fiskale, alokohen burime për nevojat prioritare dhe që shërbimet publike të alokohen në mënyrë efektive dhe eficiente.
Investitori publik	Qeveritë (në nivel kombëtar, nën-kombëtar dhe komunal), si dhe organizatat e iniciuara nga qeveria (të tilla si bankat e zhvillimit dhe institucionet shumëpalëshe të financave).

Restaurimi	(I ekosistemeve) Të gjitha proceset dhe funksionet kryesore ekologjike janë rivendosur dhe i gjithë biodiversiteti origjinal është rikthyer.
Investitori me pakicë	Një investitor individual, jo profesional, i cili blen letra me vlerë për llogarinë e tij/saj personale, e jo për një organizatë ose për të tjerët. Investitorët me pakicë zakonisht veprojnë përmes firmave ndërmjetësuese tradicionale ose në internet ose përmes llojeve të tjera të llogarive të investimeve.
Fondet revolvuese	Një fond që mund të rinovohet vazhdimisht dhe të plotësohet me të ardhura të reja në baza të rregullta.
Letrat me vlerë	Çdo aktiv (mjet) financiar që ka vlerë dhe mund të tregtohet. Letrat me vlerë zakonisht klasifikohen ose si ekuitet (aksione dhe pjesëmarrje) ose borxhe (siç janë bonot dhe obligacionet).
Fondet e amortizimit t;	Fondet që tërheqin një shumë të caktuar të financimit për një periudhë të caktuar kohore.
Indikatorët (SMART)	Një shkurtesë që do të thotë: specifik, i matshëm, i arritshëm, relevant dhe i kufizuar në kohë (Time bound). Synimi është të sqarojmë se çfarë duhet të arrihet, kur duhet të arrihet, dhe si do të dini kur jeni të suksesshëm.
Investim i përgjegjshëm shoqëror (SRI)	Praktika e investimit të parave në kompani dhe fonde që gjenerojnë kthime pozitive dhe kanë ndikim afatgjatë në shoqëri, mjedis, dhe të bërit biznes.
Bankimi i specieve	Një sistem i tregtisë ose shkëmbimit, ku kreditë mund të fitohen nga krijimi, restaurimi, përmirësimi ose ruajtja e habitateve natyrore të specieve të caktuara, dhe gjithashtu të blihen me qëllim të kompensimit ose zhdëmtimit të ndikimeve negative të aktiviteteve të zhvillimit në speciet e caktuara dhe / ose habitatin e tyre.
Subvencioni	Fondet ose përfitimet e tjera (zakonisht në formën e parave të gatshme ose një shkurtime i synuar i taksave) të dhëna zakonisht nga shteti ose një organ publik për të inkurajuar industrinë, sektorët ose aktivitetet e veçanta, ose për të mbajtur të ulët çmimin e një malli ose shërbimi. Një subvencion zakonisht jepet për të hequr një lloj të barrës, dhe shpesh konsiderohet se është në interesin e përgjithshëm të publikut, dhe se është dhënë për të promovuar një të mirë shoqërore ose një politikë ekonomike.
Mbitaksa	Një tarifë ose vlerë e shtuar në koston e mallrave ose shërbimeve nga prodhuesit dhe shitësit me pakicë, dhe të paguara nga klientët dhe konsumatorët. Në kontekstin mjedisor, të ardhurat shtesë janë mbledhur për të mbështetur ruajtjen e mjedisit, përfshirë mbulimin e kostove të përmbushjes së standardeve mjedisore dhe zbutjen e ndikimeve negative, dhe kompensimin e tarifave rregullatore të vendosura nga qeveria.
Zhvillimi i qëndrueshëm	Zhvillimi që përmbush nevojat e së tashmes pa rrezikuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre.
Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm	17 objektivat që mbështesin Agjendën e vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, të miratuara nga të gjitha Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara në vitin 2015. Ato përfaqësojnë një thirrje urgjente për veprim nga të gjitha vendet në një partneritet global, dhe pranojnë se përfundimi i varfërisë dhe privimeve të tjera duhet të shkojnë më tej krahas me strategjitë që përmirësojnë shëndetin dhe arsimin, zvogëlojnë pabarazinë dhe nxisin rritjen ekonomike - të gjitha këto ndërkohë që merren me ndryshimin e klimës dhe punojnë për të ruajtur oqeanet dhe pyjet tona.
Përdorim i qëndrueshëm	Përdorimi i biodiversitetit, ekosistemeve dhe burimeve natyrore të ripërtrishme në një mënyrë dhe në një shkallë që nuk çon në rënien e tyre afatgjate, duke ruajtur kështu potencialin e tyre për të përmbushur nevojat dhe aspiratat e brezave të tanishëm dhe të ardhshëm.
Speciet e kërcënuara	Një specie bimore ose shtazore për të cilën merret si e mundshme, që në të ardhmen e afërt, do të rrezikohet si e tërë në masë të madhe.
Fondet e mirëbesimit	Subjekti juridik që mban pronë ose pasuri në emër të një personi tjetër, grupi ose organizate. Mund të përfshijë para, pronë, aksione, biznes ose një kombinim të këtyre.
Kujdestar	Një person ose firmë që mban dhe administron pronë ose pasuri për përfitimin e një pale të tretë.
Parimi përdoruesi pagan	'Përdoruesi pagan', ose 'përfituesi pagan', është një qasje çmimi bazuar në idenë se shpërndarja më efikase e burimeve ndodh kur konsumatorët paguajnë koston e plotë të mallrave dhe shërbimeve që ata konsumojnë.
Tarifat e përdoruesit	Tarifa ose pagesa e paguar pronarit të objektit për përdorimin e objektit. Njerëzit paguajnë tarifa të përdoruesit për përdorimin e shumë shërbimeve dhe objekteve publike. Në kontekstin mjedisor, tarifat e përdoruesve, ndër të tjera, përfshijnë tarifat e hyrjes dhe tarifat që lidhen me aktivitetin në parqet kombëtare dhe zonat e mbrojtura.
Kapitali i investuar	Financimi i kapitalit për një biznes të ri ose në zgjerim që vjen nga investitorë të jashtëm (individë, firma kapitale, banka investimesh dhe çfarëdo institucioni tjetër financiar). Ashtu si financimi i parave të gatshme, edhe kapitali i investuar mund të përfshijë ekspertizë menaxheriale dhe teknike.



german
cooperation

DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Publikuar nga
Deutsche Gesellschaft für
Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Selitë e regjistruara
Bonn dhe Eschborn, Gjermani
Fondi i hapur rajonal për Evropën Juglindore - Implementimi i
marrëveshjeve të biodiversitetit (ORF BDU)
GIZ - ORF BDU
Bulevar Mihaila Pupina 115D/IV
Beograd, Serbi
Tel.: +381 (0)11 425 22 88
Kristina.kujundzic@giz.de
giz-serbien@giz.de
<https://www.giz.de/en/worldwide/72799.html>
<http://balkangreenenergynews.com/category/giz-orf-bd/>

Versioni
Maj 2020

Dizajni
Nenad Mirković
Novi Sad, Serbi

Fotografitë
Boris Erg

Teksti
Mladen Lazić dhe Lucy Emerton

Përkthimi/ lekturimi
AB& Associates, Translation Services and Event Management Agency

Opinionet e dhëna në këtë botim përfaqësojnë mendimin e autorëve
dhe nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e Deutsche Gesellschaft
für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe të Ministrisë
Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)

Në emër të
Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
(BMZ).

